



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezimi Primenje / Prodato Reception / Delivery	30.06.2023	3	viti god year
Organ / Shërbimi Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKM/BHCK	4995/2023	1/3
Shifra e Folig Appendix			
Sifra Kantimit Quantity			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.751/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.751/2023 të datës 17.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.06.2023 njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Drejtori i Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë shqyrtimin e rastit të ankuesit

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Përmes emailit të datës 20.03.2023 nga znj. H.M është kërkuar nga ankuesi që të shikoj formularin lidhur me identifikimin e sistemeve shtetërore dhe të njoftohet se ku mund të kategorizohet institucioni i Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit, ndërsa ankuesi më datë 20.03.2023 ka dorëzuar formularin me të dhëna tek znj. H.M, mirëpo që nga ajo datë nuk ka marrë ndonjë përgjigje lidhur me këtë çështje.

Ankuesi me datën 17.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4315/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendim ankimore se ndihet i dëmtuar nga neglizhimi i Zyrtarit Kryesor Administrativ në Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit pasi që kërkesa e ankuesit nuk është dërguar në Komisionin Profesional Qeveritar për Vlerësim të Detyrave të ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Autoritetin Rregullator për Shërbime me Ujin. Ndërsa Këshilli, me datë 31.05.2023 përmes e-malit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4315/2023 të datës 17.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërimin me numër 236 të datës 25.03.2019; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 25.03.2019 për pozitën e punës Zyrtar i larte për teknologji informative; Emalin e datës 20.05.2023 të V.B drejtuar H.M; Emalin e datës 20.03.2023 të H.M drejtuar V.B; Emalin e datës 13.03.2023 të Komisionit SSHIKRS drejtuar A.D; Pyetësin për Identifikimin e Sistemeve Shtetëror të Informacionit dhe Komunikimit me Rendësi Strategjike; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.05.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 31.05.2023; Listën e pagave për muajin Mars-2023; Listën e pagave për muajin Prill-2023; Diplomën universitare Nr.362 të datës 22.01.2009; Diplomën universitare të datës 20.03.2014; Vendimin me numër 614/3627 të Kryetares së Këshillit Shtetëror për Njohje.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit në pozitën e punës "Zyrtar i Larte për Teknologji". I njëjti më datë 17.05.2023 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor se ndihet i dëmtuar nga neglizhimi i Zyrtarit Kryesor Administrativ në Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit pasi që kërkesa e ankuesit nuk është dërguar në komisionin profesional qeveritar për vlerësim të detyrave të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar nenin 4 të Rregullore (QRK) Nr. 11/2023 për Ekspertët, i cili ka përcaktuar se: "4. 1. Institucioni i cili vlerëson se posedon, menaxhon ose koordinon funksionimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike e që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të bëjnë kërkesë tek Komisioni, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje. 2. Kërkesa e Institucionit për konsiderimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike shtetërore duhet të përmbajë: 2.1. informacionin për nivelin e klasifikimit të sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.2. kategorinë e shërbimeve që ofrojnë sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.3. përshkrimin e të dhënave që përmbajnë sistemet përkatëse; 2.4. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e objektivave të institucioneve shtetërore; 2.5. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e obligimeve ligjore të institucioneve kërkuese dhe institucioneve tjera shtetërore; 2.6. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e shërbimeve esenciale siç janë: shërbimet publike, shëndetësia, siguria, drejtësia, arsimi dhe mbrojtja; 2.7. rrezikun për sisteme përkatëse të rrjetit dhe informacionit nga sulmet kibernetike të brendshme apo të jashtme; 2.8. funksionet menaxhuese/koordinuese dhe shkallën e njohurive të specializuara që kërkohen për menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe avansimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.9. periudhën kohore të përcaktuar që sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit mund të mbeten jashtë funksionit; 2.10. sa është unik në nivel shtetëror secili sistemi përkatës i rrjetit dhe informacionit dhe a

ofrohen shërbime të ngjashme edhe nga sisteme të tjera të rrjetit dhe informacionit nga institucione tjera shtetërore; 2.11. përshkrimin e informacioneve të tjera të rëndësishme për sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit që nuk janë përshkruar më lartë dhe që e bëjnë të nevojshme vlerësimin e këtyre sistemeve të rrjetit dhe informacionit si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike shtetërore, 2.12. datën e futjes në funksion të sistemeve përkatëse të informacionit dhe komunikimit; 2.13. emërtimin e pozitave kyçe që janë përgjegjëse për dizajnimin, menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemet përkatëse të informacionit dhe komunikimit, dhe propozimin për kategorizim të tyre sipas klasave të përcaktuara në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, 4. Kërkesa e aprovuar nga Zyrtari më i lartë administrativ i institucionit, dërgohet tek komisioni qeveritar për vlerësim të sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike.

Andaj bazuar në dispozitat e lartcekura po ashtu edhe bazuar në shkresat e lëndës organi i punësimit respektivisht Drejtorit i Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit është i obliguar të shqyrtoj rastin e ankuesit në pajtim me dispozitat ligjor në fuqi duke marr për bazë pozitën që mban ankuesi, dhe varësisht nga konstatimit i gjendjes faktike duke marr për bazë kriteret e përcaktuar me rregulloren e lartcekura të ndërmarr veprimet konform Rregullores (QRK) Nr. 11/2023 për Ekspertët.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.751/2023

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.